



FJALA E HAPJES SË KONFERENCËS

Prof. as. dr. Engjëll Licaj,
Kryetar i Këshillit Shkencor të Konferencës

Të nderuar pjesëmarrës!

Më lejoni të falënderoj gjithë të ftuarit të cilët na nderojnë me prezencën e tyre në këtë aktivitet shkencor. Ju siguroj se koha që po vini në dispozicion të kësaj konference do të jetë kohë mjaft e dobishme.

Trajtimet shkencore të kësaj konference do të jenë në shërbim të komunitetit, si ato punime që do të kenë për tematikë sekretet e shëndetit dhe trajtimin e shumë sëmundjeve, ashtu dhe temat me objekt mjedisin dhe problematikat e lidhura me të. Temat me karakter ekonomik dhe ato me karakter gjuhësor e filozofik, gjithashtu, do të përbëjnë vlera të tjera të kësaj konference.

Nivelin e konferencës do ta udhëheqin punimet e kryera në lëmin e kërkimeve shkencore. Këto punime do të prekin shqetësimet aktuale të komunitetit tonë, qofshin këto shqetësime direkte, imediate, të përditshme, të shfaqshme, si dhe shqetësime të perspektivës, të qëndrueshme, të lidhura me punësimin, me mirëqenien, me shëndetin e shkollimin.

Këshilli shkencor, nisur dhe nga rezultatet e këtij ballafaqimi të sotëm, do të planifikojë programe shkencore të përballueshme për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të komunitetit.

Programet do të jenë konkrete, me problem aktuale. Në to do të gjendet mendimi i studentëve, ballafaqimet me qeverinë lokale, studimet epidemiologjike, statistikore të lidhura me mjekësinë, studime fizike e kimike të lidhura me mjedisin, etj.

Fatkeqësisht, deri më sot në Shqipëri në këto dy dekadat e fundit, puna shkencore ka qenë përqëndruar, kryesisht, në marrje titujsh e gradash si qëllim në vetvete.

Këshilla ime për kërkuesit e pedagogët e rinj është: guxim, guxim e prapë guxim. Të synosh të merresh me punë shkencore duhet durim, këmbëngulje, modesti, dyshim dhe përplasje. Eshtë e para konference që ne organizojmë dhe tema e zgjedhur "Shkenca në ndihmë të Komunitetit" në dukje opake, e gjerë e pa subjekt të përcaktuar, por ajo rëndësinë e ka tek kontributi në komunitet. Pranuar të orientojmë diskutimet e punimeve tona të kërkimit shkencor me këtë temë të gjerë dhe jemi të ndërgjegjshëm për modestin e kësaj konference për shumë arsye:

Së pari, jemi shkollë e lartë relativisht e re, por me bindje se kemi mundësi të shumta në të ardhmen e afërt të marrim përsipër shumë dhe do të bëjmë gjithçka për të arritur objektivat akademike dhe ato shkencore.

Së dyti, të marrësh përsipër një konference shkencore dhe për më tepër të gjesh lidhjet e saj me komunitetin, merr përsipër të gjesh lidhjet dhe dobitë e shkencës me komunitetin. Sot nuk flitet më për shkencë dhe ne këtu nuk jemi për shkencën në vetvete. Nuk jemi vetëm për shkencën teorike, por aplikimet e saj në terrenin tonë shqiptar.

Sot shkencat janë univërse të veçanta njohurish, aplikimesh, filozofimesh nga mikrobota në makrobotë, nga aplikimi më i thjeshtë deri tek ai më global.

Sot bota shkencore po jeton shpërthime të mëdha e të pandalshme. Nga ana tjetër nevojat e popullsisë dhe në një komunitet të veçantë janë pambarim, të shumta e komplekse, ku përfshihen çështje të teknologjive, të shkencave të aplikuara, të shëndetit, të ushqimit, të mirëqenies, të lumturisë shoqërore, të



punësimit të qëndrueshëm, të rinisë, të jetëgjatësisë e të plotësisimit të nevojave artistike dhe intelektuale.

Shkolla jonë duhet të gjejë vazhdimisht pikat e kontaktit dhe në politikat e saj të hartimit të programeve, të hapjes së degëve të reja, zhvillimit të drejtimeve shkencore të ketë së pari, nevojat imediate e të perspektivës së komunitetit.

Ne kemi disa avantazhe:

Së pari, jemi Akademi e Shkencave të Aplikuara, pra, degët tona të studimit në kuadër të harmonizimit me programet e studimit të shkollave të larta dhe në përputhje me procesin e Bolonjës, kanë në themel shkencën e aplikuar. Shkencat tona të aplikuara mjekësore kanë avancuar në të dy drejtimet: në atë akademik shkencor dhe në aplikim.

Dhe frutet ka filluar t'i ndjejë komuniteti. Vizitat mjekësore në Fizioterapi, Stomatologji, këshillimet e kontributi në spital e në klinikat e infermierisë e të farmacisë, janë tashmë të planifikuara dhe shumë shpejt do të marrin karakter masiv jo vetëm për Vlorën e rrethinat, por edhe më tej.

Së dyti, kemi një besim më shumë, sepse shohim që Presidenca e Universitetit është shumë e motivuar për t'iu përgjigjur sfidave të kohës për përsosjen e universitetit e për t'u bërë universitet elitare në shkencat e aplikuara. Hapja e kabineteve e laboratorëve, hapja e qendrës shkencore e cila do të udhëheq gjithë aktivitetin kërkimor është marrë seriozisht nga presidenca.

Së treti, stafi i zgjedhur me përvojë në fushën akademike dhe të kërkimit shkencor, i kombinuar me pedagog të rinj të shkolluar dhe në universitetet perëndimore do të përbëjë bazën e sigurt për të promovuar akademikët e rinj, por dhe për të rritur akreditimet dhe rankimin e universitetit në radhë me universitetet më të mirë të rajonit.

Së katërti, ne tashmë kemi të firmosur kontrata bashkëpunimi me Universitetin e Salernos dhe të Mesinës. Kontratat përfshijnë studime të përbashkëta në shumë projekte akademike e shkencore. Për herë të parë do të aplikohet për studentët lëvizja e ndërsjelltë erasmus dhe ajo që do të jetë e veçanta më e madhe është nxjerrja e një diplome të përbashkët e njohur nga të dy vendet: Akademia "Reald" dhe

Universiteti i Salernos.

Me besim se përparësi do të jetë dhe konferenca që po organizojmë sot. Kjo konferencë s'është e vetmja, por këtë muaj do të ketë dhe një tjetër mbi studimet stomatologjike në të cilën pjesëmarrja e profesorëve nga Salerno është tashmë e deklaruar.

Konferenca e sotme do të tregojë pjekurinë e studimeve të bëra nga pedagogët tanë: pedagogët e Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali", të Universitetit të Tiranës e të Spitalit Rajonal të Vlorës.

Niveli i këtyre studimeve është i niveleve të larta dhe do të hapë perspektiva të mëtejshme mbi punën kërkimore-shkencore.

Pedagogët e shkencave ekzakte, të cilët tashmë me eksperiencën e tyre në universitete në punën kërkimore e kanë treguar në vite dhe në kushtet e prodhimeve masive do të sjellin eksperiencën në ato drejtime, ku ata kanë punuar më gjatë.

Konferencën e kemi menduar ta zhvillojmë në dy seksione: në seksionin e studimeve mjekësore dhe në seksionin e studimeve mjedisore.

Kemi zgjedhur këto dy drejtime duke menduar se sot shëndeti dhe mjedisi më shumë se kurrë janë në qendër të vëmendjes së gjithë kërkimeve dhe studimeve.

Kërkuesit e rinj shkencor të mjekësisë sot ndeshen me zhvillime e përparime në shumë fusha të shëndetit publik, të cilat përmbysin njohuritë në çdo dhjetëvjeçar e në më pak se kaq. Publikimet shpesh janë kontradiktore me njëra-tjetrën. Studimet laboratorike dhe ato statistikore duhet të verifikohen në mënyrë objektive dhe konkrete me rezultate.

Mjetet e diagnostikimit sot janë nga më të sofistikuarat. Terapitë duhet të jenë të miratuara e të ndiqen me protokoll. Rezultatet duhet të evidentohen e të konkludohen me baza shkencore dhe në rastet ekstreme të dështimeve.

Vendi ynë, së fundi, është i deklaruar si i rrezikshëm nga ana shëndetësore për të jetuar dhe për këtë duhet të punohet me kujdes.

Ndoshta, zëri shkencor i mjekëve, fizikanëve, kimistëve e i biologëve ende s'ka gjetur intensitetin dhe frekuencën e duhur për t'u bërë i dëgjueshëm dhe vendin e këtij zëri e kanë pushtuar injoranca e njerëzve të thjeshtë, e ka pushtuar interesi imediat i investitorëve të



paskrupullt, sidomos në ndërtimin e banesave, e ka pushtuar përfshirja e politikës dhe politikanëve në shqyerjen e çdo vlere të këtij vendi për përfitime personale.

Për mjekësinë shkencore nuk ka e nuk duhet të ketë ndarje midis mjekësisë allopatike të trajtimit farmakologjik të pacientit dhe homeopatike ose të mjekësisë alternative, por thjesht duhet mjekësi, e cila të sigurojë jetëgjatësinë e popullsisë. Në rastet e sëmundjeve të ashtuquajtura të pashërueshme, të vështira për t'i siguruar pacientit jetëgjatësi, bluzat e bardha duhet të jenë aty jo vetëm me trajtime paliative, por të bëjnë trajtim psikologjik dhe mbështetës deri në largimin e tij. Në Afrikë trajtimi tradicional me bimë mjekësore zë 80% të trajtimeve kundrejt 20% me medikamente të kompanive farmaceutike. Në Azi trajtimi shkon në 50%. Në luftën midis trajtimeve të pacientit me medikamente apo me trajtim alternative, bluzat e bardha nuk duhet të jenë në mbështetje të kompanive farmaceutike.

Sot janë të diskutueshëm trajtimet për sëmundjet kancerogjene. Ka më se 100 vjet gati që përdoren metoda të njëjta kurimi, si: operacionet, rrezatimet radioaktive dhe trajtimet kimike për luftën kundër tumoreve e qelizave kancerogjene. Por ç'thonë realisht statistikat? Këtu ka shumë për të qëndruar e për të diskutuar. Në të ardhmen, epidemiologjistët në bashkëpunim me statisticinët duhet të këmbëngulin për rezultate konkrete e të matshme. Dozat e larta radioaktive për të luftuar qelizat kancerogjene, përgatisin si efekte anësore qeliza të reja po kancerogjene.

Institute ndërkombëtare, që studiojnë shkaqet e sëmundjeve kancerogjene dhe trajtimin e pacientëve, janë përqëndruar, kohët e fundit, në trajtimin ushqimor të ndryshuar.

Largimi i pacientëve nga duhani, alkooli, nga proteinat shtazore, sidomos nga mishi i kuq dhe ulja e kalorive ditore duke shtuar sa më shumë ushqimet që eliminojnë çlirimin e radikaleve të lira, janë disa nga rezultatet e predikuara nga këto institute.

Për vendin tonë, i cili deri para pak vitesh kishte rezultate në profilaksi e në parandalimin, duhet të bëjnë më shumë. Ja pse dhe ne e kemi menduar dhe duam të japim ndihmesën në këtë konferencë. Kemi parashikuar tema të cilat do të hedhin dritë mbi disa realitete mjedisore

të vendit tonë dhe konkluzionet që do dalin dhe nga diskutimet në këtë konferencë, kemi besimin se jo vetëm do të publikohen, por do t'i propozohen pushtetit lokal e atij qendror detyra konkrete.

Jam i bindur se të gjithë referuesit dhe diskutantët do ta përqendrojnë vëmendjen për të dhënë sa më shumë këshilla të vlefshme.

Në shkencat e ambientit rëndësi merr dhe prezenca e materies organike, e cila ka ciklet e veta të formimit e të shformimit. Mjediset tona të pas viteve '90 dhe jo vetëm tonat, por dhe të shumë shteteve të tjerë, ku përdorimi i plastikës ka pësuar një shpërthim të pandalshëm, janë të ndotura rrezikshëm nga prezenca e tyre.

Cikli i dekompozimit të tyre është shumë i ngadaltë. Ky cikël nuk bën të mundur pjesëmarrjen pozitive në ekosistem, përkundrazi, ngjyruetit dhe elementët e ndryshëm shtesë në përgatitjen e masës së brumit të plastikës i bën dhe më të rrezikshëm e negativ për ekosistemin.

Faktorët mjedisorë, si:

- * Ajrimi i terreneve ku janë të përqendruara mbetjet,

- * Temperatura e këtyre mjedisëve e lidhur me klimën dhe mikroklimën e shkaktuar nga djegiet pa kriter,

- * Lagështia e lartë e qytetit tonë,

- * pH i dheut ku gjendet plastika që varion shumë nga terreni në terren,

- * Prania e metaleve të rëndë, të cilët frenojnë metabolizmin e dekompozuesve të gjallë si mikroorganizmat, të gjithë pa përjashtim, shto këtu dhe kulturën e dobët të banorëve, luajnë rol në përsheptimin dhe cilësinë e dekompozimit. Dekompozimi, i cili, sa më shumë të realizohet në mjediset e banuara, në det, në bujqësi, në pyje, etj., aq më shumë përshepton përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme kancerogjene.

Studimet dhe publikimet deri më sot mbi prezencën e mikrogrimcave PM 10, të shkaktuara në atmosphere, janë bërë dhe nga në si fizikanë.

Deti Mesdhe

Edhe pse ky det konsiderohet si deti më i survejuar i botës, ai është duke vuajtur.

Vuan nga vendet e litoralit, sepse e kanë konsideruar dhe e konsiderojnë si basen, ku mund të derdhen naftë, ndotës kimikë, bitum, metale të rëndë duke kërcënuar faunën dhe



florën e këtij deti dhe, nga ana tjetër, shëndetin e atyre që notojnë në këtë det.

Dhe përgjegjës kryesor për këtë degradim mjedisor kudo në vendin tonë jemi ne qytetarët e këtij vendi.

Turizmi dhe turistët elitarë për ne duhet të jenë nordikët. Ata kërkojnë klimën dhe ushqimet e Mesdheut. Ne duhet të jemi atraktivë, por jemi ende larg. Turistët e këtyre vendeve mund të shtrijnë tek ne intervalin kohor jashtë sezonit të lartë turistik, së paku, gjashtë muaj. Vërejtjet kryesore të deritanishme nga turistët për vendin tonë kanë qenë: mungesa e transportit komod publik, papastërti tronditëse, kudo plehra dhe ndotje nga ujërat sipërfaqësore, të cilat jo rrallëherë përzihen me ujërat e zeza, deti në shumë plazhe, i ndotur me ngarkesë bakteriale, shumë herë me e lartë nga normat e lejuara, kultura në shërbimet sociale e dobët dhe ushqimi i pakontrolluar, niveli i zhurmave në shumë mjedise dhe pothuaj në çdo orë të ditë-natës shkon jo rrallëherë në mbi 80 db.

Këtë vit turizmi do ta gjejë edhe më keq qytetin tonë. Mbetjeve të ndërtimit u janë shtuar mbetjet e prishjeve të ndërtimit. Rihapja e rrugëve të brendshme të lagjeve për të shtruar tubacionet e ujërave të zeza, ka shumëfishuar ndotjet. Këto ndotje janë ndotje me përmbajtje të lartë grimcash agresive kristaline dhe ato të bitumeve të asfalteve të prishur. Pra, prezenca e

grimcave PM10 dhe atyre nën 2.5 mikron, shtoi dhe prezencën e mikrogrimcave të djegieve të makinave dhe, me siguri, do të bindeni që qyteti nuk do të jetë i përshtatshëm as për banorët e tij, jo më për turistët në këtë sezon.

Një kancer mbi tre shkaktohet nga duhanpirja dhe të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm se do të jetë shumë e largët dita, kur, së paku, të respektohen mjediset publike ku nuk pihet duhan. Sot duhanpirja në mosha të reja dhe sidomos tek vajzat është rritur jashtëzakonisht. Lokalet e duhan-kafesë tek ne janë pasqyra më e mirë e psikologjisë kolektive aktuale.

Ndotësit, si: metalet e rënda, merkur, cianur, plumb, etj., oksidet e NOx, Sox, COx, si dhe ozone, ndotësit radioaktivë të të gjitha mjediseve tona, duhet të monitorohen vazhdimisht.

Në mbyllje do t'ju kujtoja një **proverbë indiane**:

*"Kur njeriu të ketë prerë pemën e fundit,
Të ketë ndotur pikën e fundit të ujit,
Të ketë vrrarë kafshën e fundit,
Të ketë peshkuar peshkun e fundit,
Atëherë ai do të bindet
se paratë nuk janë të ngrënshme.*

Faleminderit dhe suksese referueseve!